



**BASHKIA VAU DEJËS
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr _____ Prot

Vau Dejes, me _____.____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIMTE KONTRATES
ME OBJEKT PROKURIMI
BLERJE KARBURANTI PER VITIN 2023**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje karburanti per vitin 2023

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): FPP) 09134000-7, naftë

VLERA E FONDIT LIMIT: 20.228.922 (njëzet milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e njëzet e dy) leke (pa TVSH) , me burim financimi: “Vetëfinancim”.

I mbajtur sot më date **08.02.2023** në Bashkinë Vau Dejës, në prani të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK nr. 40/1 Prot., datë 07.02.2023, me afat nga nënshkrimi i kontratës deri më 31.12.2023.

- Naftë, Euro Diesel D1 (Gazoil 10 ppm) ≈127 762 litra.

Per objektin ne reference.

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi, është mbështetur i punes i ngritur per hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve te vecanta teknike, te procedures ne reference.

Gjithashtu NJP eshte bazuar në nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor.Njësia e Prokurimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te vecanta teknike.

Data e hapjes së ofertave planifikuar date 24.02.2023 Ora: 10:00

- [ëëë.app.gov.al](http://eëë.app.gov.al)
- Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip.

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, kriteret të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:



Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, janë të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standard të dokumentave të tenderit.

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES / KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a)** është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b)** nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c)** nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç)** personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d)** nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh)** nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e)** ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f)** nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g)** ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj)** ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h)** kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i)** nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.



Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **2% e vlerës së fondit limit.**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, specifikimet teknike, grafikun e lëvrimin të mallit, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëlliminkryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia gjykon vendosjen e kriterëve si vijon :

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare (2019,2020,2021), lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të *paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.*

Detyrimisht sipas percaktimeve ligjore, kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 për të gjitha vendet ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas QKB-se, sipas percaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM Nr. 285/2021 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në pikën 2/b citohet: “2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”;*

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. *Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Gjithashtu vendosja e kriterëve në reference është bërë që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.



Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

Ky kriter është ndryshuar sipas rekomandimeve të APP.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Kjo pikë përmbushet me vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/ dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se "Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.



Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik , jane argumentuar nga grupi i punes, specialistet e fushes nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit , fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:

2.3.2 Licence per tregtimin me pakice te karburanteve, gazit te lengshem naftes per automjet, per perdorim nga konsumatorët fundore ose Autorizim per ushtrim aktiviteti “Tregti me pakice te lendeve djegese Karburante”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili përcakton se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu kjo kërkesë është bazuar dhe në Ligjin Nr.8450 dt. 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” si dhe në VKM nr. 970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3. 3 Operatori duhet te kete te pakten 3 (tre) pika shperndarje te karburantit brenda Qarkut Shkoder te vertetuara nepermejt ekstraktit te shoqersie nga QKB si dhe akti i disponimit te ketyre stacioneve Certificate Pronesia ose kontrate qeraje. Njeri nga stacionet e shërbimit duhet të jetë brenda territorit të bashkisë Vau Dejës. Sherbimi ne kete pike furnizimi duhet te sigurohet per 24 ore ne çdo dite te javes.

Keto stacione te jene te pajisura me vertetim teknik ,leshuar nga organet e miratuara te vleresimit te konformitetit (OMVK), Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, per distributoret e shitjeve me pakice te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave.

Kriteri per piken 2.3.3. konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e nevojshme për garantimin e furnizimit me karburant te mjeteve motorike pa pasur nevojë të bëhen shumë kilometra vetëm për tu furnizuar. Kjo kërkesë mbështetet në nenin 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raport fletë-analizë te vlefshme për produktin Naftë Euro-Diesel D1 10PPM S.SH.EN:590-2013/A1:2017 lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj duhet përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, që vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që ofertuesi tregton, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike).



Argumentimi: Flete analiza e karburantit është një dokument i rëndësishëm, pasi dokumenton cilesine e karburantit te tregtuar nga OE. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të karburanteve te tregtuara. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-sepër ofrimin e karburantit cilesor. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/c, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj duke permbushur edhe specifikimet teknike është kërkuar që të paraqitet Raport analizimi për cilësinë e karburantit, lëshuar nga organi përkatës.

2.3.5 - Subjekti ofertues duhet te zoteroje 1 (një) automjet teknologjik të llojit AutoBot e vertetuar me akt shitjeblerje ose kontrate qeraje (e cila duhet të zgjasë dhe të mbulojë shërbimin për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës për vitin 2022) shoqeruar me Certifikaten e pronesisë, leje qarkullimi, taksat vjetore, siguracion, akt kolaudimi, certifikaten per transport mallrash te rrezikshëm brenda vendit, certifikaten e inspektimit, pashaport autoboti, i cili te bëjë të mundur furnizimin e autoritetit kontraktor. Keto dokumenta duhet te jenë brenda afatit të vlefshmerisë.

- Automjeti tekonologjik (Auto Bot) nuk duhet te jetë me kapacitet me te madh se 10 000 litra qe te kene mundesi hyrje ne ambjentet e magazines.

- Ne rast se eshte marre me qera te paraqese kontraten e qera-marrjes, te shoqeruar me lejen e qarkullimit te qiradhenesit me objektin e prokurimit ne fjale dhe Autoritetin Kontraktor, siguracionin e mjetit, taksat, Certifikaten per transport mallrash te rrezikshme brenda vendit, pashaporten e botit dhe Certifikaten e kontrollit teknik te mjetit.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem

Nr. Lloji i mjetit Targa Kapaciteti mbajtes Statusi

1 Pronesi/qira/perdorim

Kriteri per piken 2.3.5. konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Kerkesa lidhet ngushte me distancat dhe me nevoje e AK per tu furnizuar, eshte e nevojshme disponimi i minimumit 1 Autoboti ne sasi deri 10 000 litra per arsye te nevojës qe ka institucioni per mjetet qe e kane te pamundur ardhjen ne pikat e shperndarrjes se karburantit me pakice, duke qene mjete teper te renda dhe me



zinxhire. Gjithashtu sqarojme se furnizimi i ketyre mjeteve behet ne sasi te medha depozitimi dhe me kupon tatimor bashkengjitur.

Per kete arsye operatoret ekonomik ofertues qe nuk disponojne minimumi 1 autobot te tille, mund ta zgjidhin duke nenkontraktuar nje shoqeri te licensuar ne kete fushe

Eshte ne te drejten e Autoritetit Kontraktor te kerkoje garanci per realizimi me sukses te projektit, duke perfshire kerkesat per mjetet të cilat nevojiten për kryerjen e shërbimit të furnizimit me karburant.

2.3.6 -Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete I pajisur dhe te paraqese certifikatat e leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise,qe kane lidhje me objektin e kontrates, si me poshte:

- *Shoqeria duhet të paraqesë Çertifikatë të cilesisë së punimeve ISO 9001- 2015 (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*
- *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2015 (e vlefshme).(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*
- *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007 ose ekuivalent me te ISO 45001:2018 (e vlefshme).(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS).*

Ne rastin e bashkimit te operatoreve Certifikatat e mesiperme duhet te paraqiten nga secili OE.

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer sherbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

ISO 9001:2015

ISO 9001 është standardi më popullor i publikuar në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë të cilat mund të implementohen dhe certifikohen nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit.

Kërkesat e ISO 9001:2015 i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve.



Certifikimi ISO 9001 përfaqëson një konfirmim të faktit që shoqëria respekton një seri kërkesash të pranueshme në nivel ndërkombëtar. Mbajtja e certifikimit sjell disa përparësi për shoqërinë siç janë: akses tek procedurat e tenderave publike, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

ISO 14001-2015

ISO 14001 është një standard që i referohet sistemit të menaxhimit të mjedisit.

ISO 14001:2015 përqendrohet tek identifikimi i atyre aktiviteteve që mund të gjenerojnë aspekte domethënëse në mjedis dhe tek aplikimi i masave kontrolluese. Qëllimi është ulja ose eliminimi i efekteve negative mbi mjedisin të lidhura me aktivitetet e shoqërisë.

Aplikimi i ISO 14001 ndihmon shoqërinë të përmirësojë performancën e saj mjedisore nëpërmjet uljes së sasisë të mbetjeve të gjeneruara dhe përdorimin me efikasitet të burimeve natyrore.

OHSAS 18001-2007 ose ekuivalent me te ISO 45001:2018

Çdo kompani ka detyrimin të mbrojtë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit.

ISO 45001 është standardi ndërkombëtar i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë. ISO 45001 zëvendësoi standardin OHSAS 18001.

Kërkesat e standardit ISO 45001 përfshijnë: vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve. Certifikimi ISO 45001 mund të merret nga çdo kompani, pavarësisht aktivitetit të saj si dhe risqeve të shëndetit dhe sigurisë. Ky certifikim konfirmon angazhimin e shoqërisë për të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur punonjësit e saj dhe të çdo personi tjetër në ambientet e saj.

2.3.7 - Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standarteve të Legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin e fundit.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues nuk është e penalizuar nga autoritetet përkatëse për abuzim me cilësinë e karburanteve, duke ofruar një garanci se nuk do të ketë të tilla abuzime as me sasinë e karburantit të prokuruar. Ky kriter u vendosën në përpunime me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.8- Furnizimi me karburant do të bëhet me tollona dhe autobot, kjo sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Shitësi i karburantit në rastin e furnizimit me karburant me autobot duhet të sigurojë dhe transportin e mallit deri në ambientet e AK.

Ofertuesit duhet të sjellin fletë-analizat e furnizimeve që të kenë të shprehura karakteristikat e mësipërme për karburantet.



Pikat e karburantit të furnizojnë 24 orë pa ndërprerje.

Argumentimi: Në bazë, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë asetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.9 - Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se furnizimi i mjeteve do të jetë e mundur të realizohet çdo ditë të javës brenda 24 orëve në të gjithë distributorët e furnizuesit . Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë ta ketë të nevojshme.

Argumentimi: Në bazë, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponibilitet te nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sasia e e pritshme e mallit që kërkohet për 12 muaj:

- Naftë, Euro Diesel D1 (Gazoil 10 ppm) $\approx$ 127.762 litra, me specifikime teknike si më poshtë (referuar standardit SSH EN 590:2013+A1:2017)

Substanca	Njësia matëse	Limitet (normat)		Metoda e provës
		Minimum	Maksimumi	
Numri i Cetanit		51	-	EN ISO 5165 EN 15195



				EN 16144
Indeksi Cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 gradë celcius	Kg/m ³	820,0	845,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarbure Polycyclic aromatike	% (m/m)	-	8,0	EN 12916
Përmbajtje squfuri	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884 EN ISO 13032
Përmbajtje Mangani Deri 31-12-2013 Nga 01.01.2014 në vazhdim	mg/l	- -	6,0 2,0	Pr EN 16576
Pika e ndezjes	Gradë celcius	Mbi 55	-	EN ISO 2719
Karboni i mbetur (në 10%mbetje distilati)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Kontaminimi total	mg/kg	-	24	EN 12662
Gërryerja e shiritit bakrit (3 orë në 50 gradë celcius)	Grada	Grupi 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e Acidit të ngopur metil ester FAME	% (V/V)	-	7,0	EN 14078
Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m ³ h	- 20	25 -	EN ISO 12205 EN 15751
Lubrikimi, diametri i veshjes së mprehte (ësd 1,4) në 60 gradë Celsius	µm (micrometer)	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 gradë Celsius	Mm ² /s	2,000	4,500	EN ISO 3104
Distilimi % (V/V) rafinimi në 250 gradë celcius % (V/V) rafinimi në 300 gradë Celsius 95 % (V/V)rafinimi në	% (V/V) % (V/V) Gradë celcius	85	Më pak se 65 360	EN ISO 3405 EN ISO 3924
a. Për qëllimet e këtij Standardi Evropian, hidrokarbonet policiklikë aromatikë janë caktuar si përmbajtja totale e hidrokarboneve aromatike më pak se				



përmbajtja e hidrokarboneve mono-aromatike, të dyja të përcaktuara në EN 12916.

- b. Investigimi i mëtejshëm për kontaminimin total në metodën e provës për përmirësimin e saktësisë, veçanërisht për prezencën e FAME, nën mbikëqyrjen e CEN.
- c. FAME i përkojnë kërkesat e EN 14214, shih (3).
- d. Kur karburantet e naftës përmbajnë më shumë se 2 % (V/V) FAME , qëndrueshmëria e oksidimit e përcaktuar në EN 15751 është kërkesa për të.
- e. Për llogaritjen e indeksit të Cetanit 10%, 50 % dhe 90% (V/V)nevojiten gjithashtu pikat e RECOVERY.
- f. Limitet e distilimit në 250 gradë Celsius dhe 350 gradë Celsius janë përfshirë në tarifën e karburantit naftë të Doganave të përbashkëta të BE.
- g. EN ISO 3924 jep instruksione për konvertimin në ISO 3405-të dhëna ekuivalente. Shih gjithashtu 5.7.5.

Argumentimi: Lëndët djegëse lëngët për automjete duhet të jenë sipas standardit SSH EN 590:2013+A1:2017, Metodatat e provës ICS 75.160.20 Miratuar në Komitetin Teknik 19 Ratifikuar me dt. 22.11.2013. Ky standard është i njëjtë me Standardin Evropian EN 590:2013 dhe ka statusin e Standardit Shqiptar. Ky Standard Evropian u miratua nga CEN më 26 Korrik. Anëtarët e CEN-it janë të detyruar të zbatojnë Rregulloret e Brëndshme të CEN/CENELEC, të cilat përcaktojnë kushtet sipas të cilave këtij Standardi Evropian duhet t'i jepet statusi i një standardi kombëtar pa i bërë asnjë ndryshim. Për sa u përket devijimeve dhe rekomandimeve bibliografike të deritanishme për standarde kombëtare të tilla, mund të merren për zbatim vetëm nga Sekretariati Qendror ose nga njeri prej anëtarëve të CEN-it. Ky Standard Evropian ekziston në tre versione zyrtare (anglisht, frëngjisht, gjermanisht).

Afatet e lëvrimit: Sipas nevojave dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga data e lidhjes së kontratës deri më 31.12.2023.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skuklifikim.

Të gjitha kriteret në mënyre më të hollësishme pasqyrohen në DST të “**KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**”, që ndodhen në dosjen e tenderit objekt prokurimi.

NJESIA E PROKURIMIT